



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 2 paragrafi 2.3 i Ligjit nr.03/L-049 për financat e pushtetit lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.27, të dt.03.06.2008) nenit 12 i Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2019 për Organizimin Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunave me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane, nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës, sipas Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Obiliqit, nr.-I-75, të dt.30.05.2022, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të kërkesës nga DAP-ja, nr.-III-103, të dt.18.04.2023, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.28.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. MIRATOHET Vendimi për kompensim – pagesën, për 12 Kryetarët e Këshillave Lokale në Komunën e Obiliqit.
2. Për punën e tyre, Kryetarët e Këshillave Lokale, kompensohen vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik, në vlerën financiare ekuivalente me anëtarët e Komiteteve obligative.
3. Kompensimi – pagesa nga pika 1 e këtij vendimi do të bëhet nga kategoria ekonomike paga dhe shtesa.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim (DEFZH) dhe Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme.
5. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

T'i dërgohet
-Kryetarit
-Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DEFZH
-DAP
-MAPL

